



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:227462  
Datë: 17.03.2025  
Numri i dokumentit: 06999358

**Ac.nr.6537/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Liridon Maloku e Halide Reka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. B. nga P. ... A.D. nga .... dhe N. I. nga P., Lagjja ....., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Jeton Osmani avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sha. me seli në Prishtinë Rr.”Nëna Terezë” nr.36, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fidane Shala-juriste pranë të paditurës, lidhur me çështjen juridike kontestuese, për kompensimin e diferencës në paga, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.52/18, të datës 13.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **05.03.2025**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sha. me seli në Prishtinë Rr.”Nëna Terezë” nr.36, **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.52/18, i datës 13.05.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e ankimuar C.nr.52/18, të datës 13.05.2022, ka vendosur si në vijim: I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: I. B. nga P., A. D. nga O. dhe N. I. nga P. dhe detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës Sha. me seli në Prishtinë, që paditësve t’ia kompensoj shumat si në vijim: -Paditësit I. B. në emër të diferencës në pagë sipas kontratës paraprake, për 10 € në muaj nga data 01.10.2016 e deri me datë 31.08.2021, në emër të bruto pagës shuma prej 590.00 €, diferencën e kontributit pensional në emër të punëdhënësit 5% në shumë prej 29.50€, diferenca që duhet paguar trustit pensional në shumë prej 29.50. € dhe tatimi në paga që duhet paguar në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës në shumë prej 33.85€ dhe në emër të pagës neto shumën prej 526.65€, -Paditësit A.D.

në emër të diferencës në pagë sipas kontratës paraprake, për 20 € në muaj nga data 01.10.2016 e deri me datë 31.08.2021, në emër të bruto pagës shuma 1,239.00€, diferencën e kontributit pensional në emër të punëdhënësit 5% në shumë prej 61.95€, diferenca që duhet paguar trustit pensional në shumë prej 61.95 € dhe tatimi në paga që duhet paguar në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës në shumë prej 95.51€ dhe në emër të pagës neto shumën prej 1,081.54 €, -Padiësit N.I. në emër të diferencës në pagë sipas kontratës paraprake, për 30 € në muaj nga data 01.10.2016 e deri me datë 31.08.2021, në emër të bruto pagës shuma 1,770.00 €, diferencën e kontributit pensional në emër të punëdhënësit 5% në shumë prej 88.50 €, diferenca që duhet paguar trustit pensional në shumë prej 88.50 € dhe tatimi në paga që duhet paguar në dobi të Buxhetit të Republikës së Kosovës në shumë prej 145.95€ dhe në emër të pagës neto shumën prej 1,535.55 €, -të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë (datë 13.05.2022), e deri në përmbushje definitive, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmarimit me dhunë. II.DETYROHET e paditura që padiësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 968.40 €, në afatin kohor prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij Aktvendimi e paditura përmes të autorizuarit të saj në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e të paditurës të aprovohet si e bazuar, duke ndryshuar Aktgjykimin e atakuar dhe hedhur poshtë padinë e padiësve si të palejuar.

Padiësit kanë parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që Aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

#### **-Ankesa e të paditurës është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se padiësi, në gjykatën e shkallës së parë me datë 09.01.2018, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për pagesën e diferencës në pagë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, në seancën për shqyrtim kryesor ka administruar provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se padiësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar tek e paditura dhe janë sistemuar në vendet e punës si “garderobier”, derisa para se të shpallehin “invalid” të kategorisë së III-të kanë qenë të sistemuar në vendin e punës si “pultist”. Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se e paditura ka ekzekutuar Aktvendimet me të cilat padiësit janë shpallur “invalid” ashtu që nga vendi i punës “pultist” janë sistemuar në vendin e punës si “garderobier” dhe se me Vendimin e Gjykatës Themelore të Punës së bashkuar në Prishtinë KT.nr.785/90 të dt.16.11.1991 padiësve u është njohur e drejta në pagesën e

diferencës së të ardhurave personale në mes të vendit të punës “garderobier” dhe vendit të punës në të cilin më parë kanë qenë të sistemuar si “pultist”. Gjykata gjeti se paditësit kanë realizuar pagë mujore bruto në shumë prej 486,00 €. Gjithashtu gjeti se paditësit janë drejtuar të paditurës, me kërkesa për realizimin e diferencave në pagës, mirëpo e paditura nuk është përgjigjur në këto kërkesa. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësit kanë të drejtë për sistemim në vendin e punës tjetër i cili u përgjigjet aftësive punuese të tyre pas shpalljes si “invalid” të punës të kategorisë së III të invaliditetit i cili është shkaktuar gjatë marrëdhënies së punës si dhe kanë të drejtë në kompensimin e diferencave në të ardhura personale të cilat paguhen, në mes të vendit të punës në të cilin kanë qenë të sistemuar para keqësimit të gjendjes dhe vendit të punës në të cilin janë sistemuar pas keqësimit të gjendjes shëndetësore nga se këto të drejta janë të drejta që u takojnë paditësve. Pretendimet e palës së paditur se padia është e pasafatshme, gjykata nuk i pranon si të qëndrueshme, kjo pasi që në bazë të dispozitës së nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës është përcaktuar se: ” *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*”, duke pas parasysh faktin se paditësit me padi kanë kërkuar kompensimin e diferencës në pagë, nga pozita të cilën kanë pas si “pultist” dhe tani në pozitën e punës “garderobier”, sipas kontratës së punës për paditësin I. B.me nr.4810/0 të dt.01.10.2016, për paditësin A. D., kontrata e punës nr.5159/0 e dt.01.10.2016 dhe për paditësin N.I., kontrata e punës nr.5613/0 e dt.01.10.2016, janë kërkesa materiale, për të cilat afati i parashkrimit është tre vjeçar, ndërsa që paditësit kanë paraqitur padinë brenda këtij afati me dt.09.01.2018. Shumën e diferencës së të ardhurave personale të paditësve mes të vendit të mëparshëm të punës si “plutist” dhe vendit të punës si “garderobier”, gjykata e ka gjykuar në bazë të Ekspertizës financiare të ekspertit financiar gjyqësor Flamur Keqa. Nga kjo ekspertizë rezulton se paditësit I. B. në emër të diferencës në pagë e paditura duhet të ia kompensoj shumën neto prej 526.65€, në emër të tatimit të mbajtur në burim shumën prej 33.85€, në emër të kontributit pensional nga punëmarrësi shumën prej 29.50€ dhe në emër të kamatës për periudhën prej 01.10.2016 e deri me 31.08.2018 shumën prej 114.07€, paditësit A. D. në emër të diferencës në pagë e paditura duhet të ia kompensoj shumën neto prej 1081.54€, në emër të tatimit të mbajtur në burim shumën prej 95.51€, në emër të kontributit pensional nga punëdhënësi shumën prej 61.95€ në emër të kontributit pensional nga punëmarrësi shumën prej 61.95€ dhe në emër të kamatës për periudhën prej 01.10.2016 e deri me 31.08.2018 shumën prej 228.13€ ndërsa paditësit N. I. në emër të diferencës në pagë e paditura duhet të ia kompensoj shumën neto prej 535.55€, në emër të tatimit të mbajtur në burim shumën prej 145.95€, në emër të kontributit pensional nga punëdhënësi shumën prej 88.50€ në emër të kontributit pensional nga punëmarrësi shumën prej 88.50€ dhe në emër të kamatës për periudhën prej 01.10.2016 e deri me 31.08.2018 shumën prej 342.20 €. Këtë ekspertizë dhe plotësimin e saj gjykata e ka aprovuar dhe ia fali besimin e plotë ngase në të janë dhënë arsyet e plota dhe të detajuara të cilat për gjykatën janë të pranueshme. Ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësit e kanë cilësinë e kreditorëve ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) parashihet se “*kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij*”, prandaj, gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitës së lartë cekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj diferencën në pagat e paditësve si në dispozitiv të këtij

aktgjykimi. Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 10.09.2020), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive dhe jo kamatën e llogaritur nga eksperti financiar dhe atë të precizuar nga i autorizuari i paditësve, pas datës së ekspertimit 31.08.2021 e deri në ekzekutimin e aktgjykimit. Gjykata lidhur me shpenzimet procedurale vendosi konform dispozitës së nenit 452.3 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet për taksën gjyqësore për padi shumën prej 60 €, për përfaqësim në tri seanca (për seancë nga 202.80 € për tre paditësa) shuma prej 608.40 € dhe për ekspertizë financiare shuma prej 300.00 €, në shumë të përgjithshme prej 968.40 €.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë tani për tani nuk mund t'i pranon si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.2 pika n), të LPK-së, meqë aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, përkundër detyrimit ligjor që rrjedh nga neni 160 parag.4 i LPK-së, në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, nuk i trajton të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, nuk sqaron se me provat e administruara cila është gjendja faktike e vërtetuar, cilave prova i ka falur besimin e cilave jo, cilat kanë qenë faktet vendimtare të cilat i ka marr për bazë me rastin e vendosjes, ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 8 të LPK-së. Në lidhje me këtë, kjo dispozitë, përkatësisht parag. 1 i saj, shprehimisht përcakton se: “Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit”, ndërsa parag.2 i të njëjtës dispozitë, përcakton se: “Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç' do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”. Si rrjedhojë, ka qenë detyrim i gjykatës së shkallës së parë që në lidhje me çështjen kontestuese të vërtetojë në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjitha faktet vendimtare, si dhe pastaj në arsyetim të aktgjykimit të jep arsyet të cilat kanë ndikuar në mënyrën e vendosjes, përfshirë këtu edhe trajtimin e të gjitha pretendimeve të ngritura nga palët ndërgjyqëse. Në këtë drejtim, siç është cekur edhe më lartë, bazuar në nenin 160 parag.4 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktgjykimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato. Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar nuk i ka trajtuar fare, përkatësisht nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm rreth pretendimeve të palës së paditur, por vetëm ka bërë përrshkrim të veprimeve dhe procedurave të cilat i ka marrë e paditura në rastin e largimit nga puna të paditësit, gjë e cila nuk është bazë e mjaftueshme për arsyetim, sepse si e tillë nuk mundë të konsiderohet arsyetim në përputhje me atë që kërkohet dhe është e përcaktuar me dispozita ligjore

Mirëpo, për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljes së dispozitave të ligjit të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n), lidhur me nenin 160 parag.

3, 4 dhe 5 të LPK-së, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe vendosje

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, se gjykata e shkallës së parë në procedurën kontestimore sipas padisë së ushtruar nga paditësi, e vlerëson ligjshmërinë e procedurës dhe raportit juridik të lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe nvarësisht nga shkeljet e konstatuara, si dhe nga lloji i kërkesës së paditësve, të merr vendimin përkatës, bazuar në dispozitat ligjore.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është prishur, atëherë domodoshmërisht është dashur të priset edhe pjesa e dispozitivit të tij, e cila ka të bëjë me shpenzimet procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos sërish në procedurën e rigjyimit.

Në bazë të shkresave të lëndës shihet se paditësi I. B. ka lidhur kontratë të punës me të paditurën me datë 01.10.2016, për kohë të pacaktuar, pozita Gardërobist, me pagë mujore prej 466.00 Euro. Ndërsa kontratën tjetër me numër 476 e datës 01.03.2014, për kohë të pacaktuar, për pozitën Graderobist me pagë mujore prej 476.00 Euro, nuk është nënshkruar nga paditësi I. B.. Paditësi A. D. me të paditurën kanë lidhur kontratën e punës me datë 01.03.2014, për kohë të pacaktuar, pozita Gardërobist, me pagë mujore prej 486.00 Euro, ndërsa kontratën tjetër të datës 01.10.2016 paditësi nuk e ka nënshkruar. Paditësi N.I. me të paditurën kanë lidhur kontratën e punës me datë 01.03.2014, për kohë të pacaktuar, pozita Gardërobist, me pagë mujore prej 496.00 Euro, ndërsa kontratën tjetër për të njëjtën pozitë me datë 01.10.2016, me pagë mujore prej 466.00 Euro.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht duhet vlerësoj ligjshmërinë e themelimit të raportit juridik, përkatësisht marrëdhënies së punës ndërmjet palëve ndërgjyqëse, është përmbushur kontrata e punës ashtu siç janë marrë vesh palët kontraktuese apo jo, se paditësit janë paguar ashtu siç janë dakorduar me të paditurën përmes kontratës së punës. Të vërtetohet faktin se paditësit janë sistemuar në vend tjetër të punës apo jo, nëse po është respektuar dispozita e nenit 17.3 të Ligjit të Punës, e cila parasheh *“I punësuarit sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive”*.

Pra fillimisht të vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve dhe më pastaj lartësia e saj.

Sipas kësaj gjykate, kontrata e punës është një marrëveshje në mes të punëtorit dhe punëdhënësit, përmes së cilës përcaktohen në mënyrë detaje të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, e cila duhet të jetë përpiluar në përputhje me Ligjin e Punës Nr.03/L-212 dhe aktet e brendshme të të paditurës. Kontrata e punës është e rëndësishme sepse nëpërmjet saj një punëmarrësi dhe një punëdhënës i kanë të definuar sakt të drejtat dhe detyrimet e tyre, periudhën e themelimit të marrëdhënies së punës (me afat të caktuar dhe pa afat të caktuar), përkatësisht

punëmarrësi i njeh të drejtat e tij dhe kushtet e punës ashtu siç është dakorduar me punëdhënësin qysh nga momenti i lidhjes së kontratës.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, të eliminoj të metat e evidentuara më lartë, por njëkohësisht duke u kujdesur edhe për çështjet e tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor dhe në këtë kuptim duhet të vlerësoj të gjitha prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me gjykatën, palët-përfaqësimin, objektin e kontestit dhe rregullsitë formale të padisë dhe të vendos për themelësinë e kërkesëpadiës së paditësve. Pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetoj gjendjen faktike, duke i vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse të cekura më lartë, si dhe duke dhënë arsytim të mjaftueshëm për këto pretendime, si dhe në fund të vendos për kërkesëpadinë e paditëses në bazë të dispozitave ligjore. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 8, lidhur me nenin 160 të LPK-së, ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, të vërtetojë bazën juridike të kërkesëpadiës, përfshirë këtu gjendjen faktike, duke i vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse të cekura më lartë, si dhe duke dhënë arsytim të mjaftueshëm për këto pretendime dhe në fund të vendosë për kërkesëpadinë e paditëses, në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 parag.1 pika (c) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.6537/2022, datë 05.03.2025**

**Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi**